



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.493/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

REFUZOHEN të pabazuar ankesat A.nr.493/2025, Anr.496/2025, Anr.497/2025, Anr.500/2025, dhe Anr501/2025, të datës 09.02.2025, të parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës .

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesat: Anr.493/2025, Anr.496/2025, Anr.497/2025, Anr.500/2025, dhe Anr501/2025, më datë 09.02.2025.

-Në ankesën **An493/2025**, pretendohet se më datë 09 shkurt 2025, pas hapjes së vendvotimeve në Qendrën e votimit në Shkollën “ Gjin Gazulli” në Prishtinë, pikërisht pas orës 07:00/h, kanë vërejtur se Lëvizjes Vetëvendosje, në afërsi prej 100 metra prej qendrës së votimit kane vendosur një baner me qëllim të ndikimit të votës tek qytetarët e Republikës së Kosovës.

-Në ankesën **Anr.496/2025** pretendohet se më datë 09 shkurt 2025, pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00/h, në qendrën e votimit në Shkollën "Hamëz Jashari" në Skenderaj, vërehet se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka të vendosur një baner/poster në afërsi prej 100 metra prej qendrës së votimit, me qëllim të ndikimit te votës tek qytetarët e Republikës së Kosovës.

-Në ankesën Anr.497/2025 më datë 09 shkurt 2025, pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00/h, kandidatja për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, znj. Egzona Tërdevci ka shpërndarë disa fotografi në Facebook, me tekstin përshkrues "Bashkë me prindërit përfunduar obligimin tonë. Vvotuar, kështu duke bërë fushatë me publikimin e shkurtesës së subjektit politik me të cilën garon në këto zgjedhje parlamentare.

-Në ankesën Anr.500-2025 pretendohet se më datë 09 shkurt 2025, në njërin nga vendvotimet në fshatin Hodonoc, komuna e Kamenicës, pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00/h, mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje është futur me veturë ne oborin e qendrës së votimit, me të cilën ka shfaqur material me qëllim të ndikimit të votuesit, ku vërehet një bluze e vendosur ne xhamin e pasme të veturës me mbi shkrimin "Lëvizja Vetëvendosje 500k".

-Në ankesën Anr.501/2025 pretendohet se më datë 09 shkurt 2025, në vendvotimin 1 30 1 në qytetin e Lipjanit, pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00/h, mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje është futur me veturë në oborin e qendrës së votimit 1 30 1 në qytetin e Lipjanit, me të cilën ka shfaqur material me qëllim të ndikimit të votuesit, ku në pjesën e përparme të veturës ka të vendosur numrin e subjektit politik LVV.

Si provë në ankesat subjekti politik PDK, ka bashkangjitur Fotografi nga qendrat e votimit dhe linqe të postimeve në rrjetet sociale.

Sipas parashtruesit të ankesës Subjekti Politik me këto veprime ka bërë shkeljen e rregullave zgjedhore, Bërja e fushatës në çfarëdo mënyrë, pas hapjes së qendrave të votimit, respektivisht pas orës 07:00/h.

PZAP iu drejtua me kërkesa për përgjigje subjektit politik LVV, i njëjti ne përgjigje ne ankesë lidhur me ankesat Anr.493/2025, Anr.496/2025, dhe Anr.497/2025, ka theksuar Si Lëvizje VETËVENDOSJE! vlerësojmë se ankesa e tillë, është e pabazë dhe e paqëndrueshme. Kjo për faktin se e njëjta, nuk përmban ndonjë fakt dhe provë të cilat do ta ndërlihdnin shkeljen e pretenduar si shkelje e cila do të binte ndesh me dispozitat e LZP-së. Ndërsa në përgjigje në ankesë lidhur me ankesat Anr. 500/2025 dhe Anr.501/2025, kane theksuar se vetura private ne foton e bashkangjitur shihet e parkuar ne një pronë – livadh , dhe se nuk mund te vërtetohet lokacioni apo afërsia me qendrën e votimit andaj nje veprim i tillë nuk është ne kundërshtim me rregullat zgjedhore.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.493/2025, Anr.496/2025, Anr.497/2025, Anr.500/2025 dhe Anr.501/2025, të datës 09.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.493/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara

nga subjekte politike PDK kundër subjektit politik LVV për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Ankesat janë të pabazuara

Paneli pas vlerësimit të ankesave dhe provave të bashkangjitura në ankesat e cituara më lartë si dhe përgjigjes në ankesë dhe provat e bashkangjitura në të, erdhi në përfundim se pretendimet e ankuesit në ankesat e tyre, se mbështetësit e subjektit politik LVV kanë thyer heshtjen zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës janë të pa bazuara.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, erdhi në përfundim se pretendimet e ankuesit në ankesat e tyre, se subjekti politik LVV ka bërë veprime të ndaluara para procesit të votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, i vlerëson si të pabazuara dhe të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete. Paneli duke analizuar ankesën A.nr.493/2025 vërtetoi se baneri është i vendosur jashtë rrethojave e po ashtu nuk vërtetohet se a është ne oborr te qendrës së votimit. Paneli duke analizuar ankesën Anr.496/2025 vërtetoi se baneri është i vendosur në objekt privat dhe nuk është vendosur brenda oborrit të qendrës së votimit. Paneli duke analizuar ankesën Anr.497/2025 vërtetoi se shkelja e pretenduar sipas kësaj ankese nuk mund të konsiderohet shkelje e heshtjes zgjedhore. Ndërsa sa i përket ankesës Anr.500/2025, Paneli ka vërtetuar se nga foto e paraqitur si provë nga ankuesi nuk është arritur të vërtetohet se është brenda oborrit të qendrës së votimit. Paneli duke analizuar, pretendimet ankimore sipas ankesës Anr.501/2025 dhe ka vërtetuar se nga fotoja e paraqitur si provë nga ankuesi nuk është arritur të vërtetohet se është brenda oborrit të qendrës së votimit.

Kështu qe PZAP-i pretendimet ankimore te cituara si me larte i vlerëson si të pabazuara dhe të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete, pasi që nga provat e bashkangjitur ankesave nuk vërtetohet se nga subjekti politik LVV është shkelur neni 37 paragrafi 1.1 dhe 1.2 *“Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit; 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Pretendimet ankimore të parashtresit të ankesave lidhur me shkeljet e pretenduara nga ana e subjektit politik në fjalë, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që parashtresi i ankesave, në ankesat e tij ka bashkangjitur disa foto, mirëpo me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetohen shkeljet e pretenduara, e që sipas vlerësimit të Panelit nuk ka shkelje të heshtjes zgjedhore dhe nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore të përmendura më lartë.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesat janë të pabazuara pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesave i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se janë kryer shkeljet e pretenduara. Andaj duke u mbështetur në nenin 1 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesit e ankesave nuk kanë arritur që të vërtetojnë pretendimet e theksuara si më lartë.

Prandaj, nga sa u tha më lartë ankesat vlerësohen si të pabazuara duke u bazuar në nenin 118, paragrafi 1, të LZP-së, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.493/2021 më datën 11.02.2025.



Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.